



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 18/3 Prot.

Tiranë, më 17/11/2010

Lënda: Rekomandim për Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k.

REKOMANDIM

Nr. 18/3, datë 17/11/2010

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k,

KONSTATOVA

Më datë 05/10/2010 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Zbatimi i kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 5,6,7,8, të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Siguria e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale.
- Njoftimi i të dhënave që përpunohen.
- Si zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.
- Si evidentohen dhe zbatohen Udhëzimet e Vendimet e Komisionerit.
- Kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren konformë kushteve dhe kriterëve të dispozitave të mësipërme.

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

1) Kontrolluesi *Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k* nuk ka kryer plotësisht detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale". Nga kontrolluesi nuk është deklaruar përpunimi i të dhënave biometrike të punonjësve që realizohet për arsye sigurie.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

2) Kontrolluesi, *Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k* nuk është shprehur në rregulloret e brendshme të hartuara prej tij lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale në zbatim të neneve 27/2 "c" dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nuk është shprehur në lidhje me kohëzgjatjen e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin këto të dhëna janë mbledhur në referencë të nenit 5 të ligjit të sipërmendur.

- Moskryerja e kësaj detyre ligjore përbën shkelje të kërkesave të nenit 27/2/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; "Kontrolluesi, udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave".
- Gjithashtu përbën shkelje të kërkesave të nenit 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj".

3) Kontrolluesi, *Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k* nuk ka kryer detyrimin ligjor për informim të punonjësve dhe subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të videosurvejimit. Konkretisht, nuk janë vendosur tabela informuese në ambjentet ku janë të vendosura kamerat e rregjistrimit. (korridoret apo ambjentet e punës së punonjësve)..

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "...Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave....".

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Të plotësohet formulari i njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke deklaruar përpunimin e të dhënave biometrike dhe qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
2. Të hartohet rregullore e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin ose në rregulloren ekzistuese të përfshihet rubrikë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale ku të parashikohet edhe kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave personale sipas qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar, duke zbatuar kërkesat e neneve 5, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
3. Të vendosen tabela informuese në të gjitha ambjentet ku janë të vendosura kamerat e vëzhgimit, si dhe sistemi të administrohet nga persona të autorizuar që janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin, në zbatim të 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”,

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

